



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 318, Datë 08.11.2023

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2023 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.11.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2369/1 prot., datë 07.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin tetor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 7551 prot., datë 02.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2369 prot., datë 03.11.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ERE merr në konsideratë vetëm komponentët e njohur sipas nenit 6, pikave 3 dhe 5 si dhe nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017.
- Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, kostot e disbalancave llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Referuar pikës 4.1.3.2 të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020, përcaktohet ndër të tjera se kostot e

balancimit duhet të alokohen tek shkaktarët e tyre në mënyrë të drejtë. Në këtë kuptim, përfshirja e këtyre kostove në tarifën e FMF devijon qëllimin për të cilin është krijuar dhe operon tregu i balancimit të energjisë elektrike, i cili është një treg konkurrues dhe që nuk operon me çmime të rregulluara.

- Mbështetur në nenin 8 të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022 të bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijoje në mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022 – 31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2023, përlogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh 12.30
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh 0.37
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh 1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 16.13

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *16.13 Lekë/kWh për muajin Tetor 2023*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin tetor 2023, prej 16.13 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI